



Në bazë të nenit 54, 63, dhe 65 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë, nr. 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, dhe 30/16) dhe neni 37 i Statutit të Universitetit, rektori miratoi këtë:

PROCEDURË PËR EMËRIMIN E DEKANIT

1. Dekan i fakultetit emërohet nga radhët e stafit akademik me orar të plotë pune të fakultetit që ka titull mësimor-shkencor profesor ordinar, profesor inordinar ose profesor vizitues (ose docent, në qoftë se nuk ka rang më të lartë dhe/apo të përshtatshëm). Periudha e emërimit është për katër vjet në bazë të vlerësimit vjetor nga Rektori dhe ajo është subjekt i rishikimit strategjik. Kriteret shtesë që duhet të përmbushen nga kandidatët janë dhënë në përshkrimin e vendit të punës i cili është publikuar në Konkurs.
2. Kjo pozitë do të publikohet nga zyra e burimeve njerëzore, restriktivisht për stafin akademik të fakultetit përkatës duke pasur parasysh thirrjen për shprehjen e interesit për një periudhë të specifikuar aplikimi. Aplikantët mund ta shkarkojnë formularin e aplikacionit nga ueb faqja e Universitetit. Aplikacionet e kompletuara në formatin dhe gjuhën që kërkohet duhet të dorëzohen brenda afatit të publikuar. Si mbështetje për aplikacionin mund të dorëzohen dëshmi përcjellëse.
3. Zyra e burimeve njerëzore, nën mbikëqyrje të sekretarit të përgjithshëm, siguron se të gjitha aplikacionet do të trajtohen në konfidencë të plotë.
4. Pas datës së mbylljes, të gjitha aplikacionet e kompletuara sipas kriterëve të parapara do t'i dërgohen për referencë rektorit.
5. Të gjitha aplikacionet do të shqyrtohen nga ana e rektorit në bashkëpunim me zyrën burimeve njerëzore. Ky shqyrtim bëhet për të siguruar pajtueshmëri me kriteret e miratuara në përshkrimin e vendit të punës . Personat të cilët gjatë shqyrtimit nuk do t'i përmbushin kërkesat do të eliminohen nga procesi dhe për këtë gjë do të informohen në kohë.
6. Të gjitha aplikacionet që e kalojnë procesin e shqyrtimit i dërgohen Këshillit të fakultetit. Në një mbledhje të veçantë, të kryesuar nga dekani ose në rast se dekani aktual është kandidat, atëherë mbledhjen do ta kryesojë prodekani i fakultetit. Anëtarët e këshillit ftohen ta komentojnë gjendjen akademike të kandidatëve dhe kapacitetet administrative dhe udhëheqëse, ashtu siç kërkohet sipas përshkrimit të vendit të punës. Kandidatët nuk duhet të jenë të pranishëm kur diskutohet aplikacioni i tyre. Me këtë rast, Këshilli i dërgon drejtpërdrejt rektorit një përmbledhje të shkruar të komenteve të tyre, por duke mos

e bërë rangimin ose votim për kandidatët. Ky raport duhet të dërgohet brenda tri ditëve pas mbajtjes së mbledhjes së këshillit të fakultetit.

7. Rektori i merr në konsideratë propozimet nga këshilli i fakultetit dhe ndonjë kandidat tjetër, aplikacioni i të cilit ka kaluar procesin e rishqyrtimit dhe vendos t'ia propozojë Komitetit ekzekutiv për miratim nga një kandidat për secilin fakultet. Rektori e ruan të drejtën që ta bëjë vlerësimin e mëtejme për performansën e kandidatëve para se të dorëzojë çfarëdolloj rekomandimi final.
8. Bordi i pranon propozimet e rektorit, sjell vendimin final, në qoftë se është e nevojshme me shumicë votash . Për vendimin e informon rektorin. Në rast të mosemërimit, procedura do të përsëritet.
9. Sekretari përgjithshëm e informon stafin dhe zyrën e burimeve njerëzore për rezultatet e procesit në afat prej tre ditëve.
10. Zyra e burimeve njerëzore e përgatit Vendimin për emërim të dekanit.

Orari i aktiviteteve në lidhje me emërimin e dekanëve:

Më 29 shkurt	Hapet thirrja për shprehje të interesit
Më 24 qershor	Mbyllet procesi i aplikimit
Deri 01 korrik	Përpilohet lista e shkurtër
Deri 12 korrik	Mbledhjet e veçanta të këshillave të fakultetit
Deri 15 korrik	Raportet e fakulteteve i përcillen rektorit
Deri 15 gusht	Intervista me kandidatët
Deri 20 gusht	Rekomandimet i përcillen Komitetit ekzekutiv
Fundi i gushtit	Emërimi i dekanëve nga Komiteti i ekzekutiv
Më 1 shtator	Dekani i ri merr pozitën